

ETHNOGRAPHY OF SPEAKING FROM THE SOCIOLINGUISTIC PERSPECTIVE

ETNOGRAFI E TË FOLURIT NË KËNDVËSHTRIMIN SOCIOLINGUISTIKË

Fridrik DULAJ¹

^{1*} Department of Linguistics, Faculty of Philology, University of Gjakova „Fehmi Agani“

*Corresponding author e-mail: fridrik.dulaj@uni.gjk.org

Përmbledhje

Sociolinguistika si disiplinë në gjuhësinë shqiptare po mbush dy dekada jetë hulumtimi dhe shqyrtimi. Tashmë rezultatet e këtyre hulumtimeve i gjejmë të publikuara në monografi e revista të ndryshme shkencore. Punimi ynë ka për qëllim të sjellë disa të dhëna të hershme të elementeve sociolinguistike në shoqërinë shqiptare para se të definohej vetë përkufizimi i saj si disiplinë gjuhësore. Për të realizuar këtë punim, jemi nisur nga teoria sociolinguistike e themeluesit të saj Joshua Fishman, i cili mendonte se hulumtimi sociolinguistik duhet të ndërtohet mbi këto kërkesa: **kush, me kë, kur dhe ku, përse a për çfarë, si flet?** Se elementi gjuhësor dhe grupi shoqëror në shoqërinë shqiptare paraqesin larmi ndërshtresore të gjuhës shqipe të kujtojmë punimin e Eqrem Çabejt për të folurit të grarisht, ose punimin e Qemal Haxhihasani për të folmet shoqërore.

Sociolinguistika shqiptare mori drejtim dhe u konkretizua mirëfilli si disiplinë gjuhësore me hulumtimet dhe shqyrtimet sociolinguistike të akademik Gjovalin Shkurtajt gjatë viteve të 90-ta të shekullit të kaluar. Duke kundruar mbi dialektet dhe të folmet e shqipes, në rrjedhën e ligjërimeve popullore mund të gjinden rrënjët e sociolinguistikës shqiptare. Në traditën shqiptare elementet e grupeve shoqërore dhe grupeve gjuhësore kanë diferencuar njëri-tjetrin në ligjërime, duke përdorur variacione sipas rrethanave shoqërore, emocionale dhe politiko-ekonomike. Të kujtojmë kujdesin dhe leksikun e zgjedhur në odat e burrave. Rëndin e ligjërimit në rrethana të ndryshme të jetës shoqërore.

Fjalët kyçe: Sociolinguistika, disiplinë, hulumtimi, grupi shoqëror, grupi gjuhësor, ligjërime, leksik, dialekt.

1. Hyrje

Studimet gjuhësore në fushën e sociolinguistikës, ndonëse janë të pakta dhe të reja në gjuhësinë shqiptare nuk dalin pa interes për t'u studiuar në ditët tona. Dikur materiale të mbledhura kryesisht për çështje folklorike dhe dialektore, këngët e dasmave dhe bisedat e zhvilluara në odat e burrave, e pse jo edhe në dhomat e grave, me rastin e martesave dhe ceremonive të tjera familjare, sot të na dalin me shumë interes për të parë nivelin e komunikimit të banorëve dhe trevave të ndryshme. Në këtë punim do të trajtojmë urimet dhe përshëndetjet në ceremoninë e dasmës nga breza të ndryshëm në të njëjtën trevë gjuhësore, duke synuar e kundruar gjithnjë në gjetjen e dukurive fonetike, morfologjike dhe sintaksore të ndryshme, të cilat në treva të tjera dëgjohen

përafërsisht ose edhe krejt ndryshe. Martesat me treva të ndryshme, jashtë rrethit të Rahovecit bartin me vete edhe shprehje të ndryshme dhe “thyejnë ligjin martesor” tradicional “dhe me dhe, fe me fe”. Jeta e njeriut është e organizuar në rrethana të tilla shoqërore, të cilat krijojnë grupin shoqëror, i cili do të krijojë edhe kodin e sjelljes dhe kulturën e të folurit. Fshatrat e rrethit të Rahovecit, martesat i bëjnë ndërmjet shqiptarësh kryesisht në mes fshatrave e më pak me qytetin dhe me zonat tjera. Shumica e martesave kryhen në rrethe të caktuara. Kjo mund të bartë me vete edhe mendimin ose shprehjen “*dhe me dhe, fe me fe*”, që do të thotë miku të jetë me doke e zakone të njëjta. Brenda në qytetin e Rahovecit, krijimi i miqësive dhe i martesave me fshatra ka qenë më pak i përhapur.

Përqindja e lidhjeve miqësore e hedh poshtë konstatimin e Nushiqit (Branisllav Nushiq, *S’Kosova na snje more*, Beograd, 1902 vep e cit. f. 25.), se gjuhën shqipe në Rahovec e kanë sjellë gratë të ardhura (martuara) nga fshatrat. Kohëve të fundit, si rezultat i emancipimit të femrës, rregulli i martesës vetëm brenda qytetit të Rahovecit, ka filluar të mos përfillet. Tashmë, vajzat rahovecase, martohen në vende të ndryshme të Kosovës, qoftë në fshat apo në qytete. Martesat ndëretnike në këtë trevë nuk ekzistojnë. Edhe nëse ka të tilla ato mund të jenë ose kanë qenë shumë të rralla dhe janë shumë specifike dhe bëhen pa pëlqimin e familjeve dhe si të tilla nuk përkrahen e miratohen kurrë nga familjarët. Në këtë trajtesë do të përpiqemi të vëmë në dukje organizimin e rriteve familjare siç janë: lindja, fejesa, martesa dhe vdekja, duke përkrahur etnografinë gjuhësore në rrethanat e ligjëritit popullor në vështrimin sociolinguistik.

2. Lindja

Një prej gëzimeve më të rëndësishme familjare, pa dyshim është lindja e fëmijës. Dikur lindja e fëmijës është përjetuar me dallime, në gëzime, kur lindte *djalë* dhe kur lindte *vajzë*. Mbase edhe sot epërsia e gëzimit për lindjen e djalit, në krahasim me vajzën hetohet, megjithëse nuk është e theksuar si dikur, kur lindte djalë zbrazej pushkë, ndërsa lindja e vajzës përcillej me heshtje. Madje “diskriminimi” është hetuar edhe kur është bërë urimi për lindjen e vajzës: *u rrit me vllazen! Ishalla i përkul vllaznit!* Si shenjë se familjarët e prisnin ardhjen në jetë të djalit. Kjo është thënë edhe nëse ka qenë fëmija i vetëm, sepse djali është konsideruar si shtylla e shtëpisë (Fridrik Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP, Prishtinë 2016, f. 317).

Me rastin e lindjes së fëmijës janë shumë shprehje që përdoren në këtë trevë. Kur jepet lajmi për lindjen e djalit: *na u ka shtu ni pushkë, na u ka shtu ni krah pune, na u ka shtu ni mashkell*. Ndërsa për lindjen e vajzës: *nu ka shtu ni mik, m’ka le mik*, me keqardhje që ka lindur vajzë, por nuk mungon urimi duke u parë dobia praktike e saj apo si shërbyese për vëllezërit që do të vijnë pas saj: *ka le magari i djemve, ishalla t’i përkund djemt, ishalla e përkund vllavin*. Urimet nga tjerët këtë ceremoni : *perhejr se u bane babë, perhejr se ishi shtue, perhejr se u bane babgjysh, perhejr se u bane gjyshe, ishalla me ymer e me nafakë, ia pafsh rriten, u rrit me vllazen e motra, e paç me ymer, koft me jet’, etj*. Në kohë të reja: *u rrit me prind, qoftë me fat e jetë të gjatë etj.*, ose për vajzën: *ishalla i përkul vllaznin*.

Ndodh, si rëndomtë në shoqërinë shqiptare, që nusja nuk është e mirëpritur nga familja dhe lindja e fëmijës, sidomos kur lind djalë, për herë të parë, në vend të urimit dëgjohen shprehje që shprehin pakënaqësi: *Shtini dreqi rrāj*. Që ka kuptimin se nusja, ndonëse e padëshiruar, tashmë kishte krijuar rrethana të reja që do t’i siguronin asaj qëndrimin në shtëpinë e burrit. Pas lindjes së fëmijës vjete radha për kujdesin ndaj tij. Prandaj zona e Rahovecit është e pasur me fjalë që lidhen me përkundjen e djepit, nënat e në të shumtën e rasteve gjyshet e kësaj zone i këndojnë fëmijët në djep duke i uruar ata që të bëhen njerëz të mirë e punëtorë të zellshëm: *Ham t’kam t’mire bukuroshe, Ham t’kam t’trash edhe t’mire, Çika nanes vet, goja me sherbet, Oj fatbardh: a je*

kumell a je dardh, *Çika shkon te daja i del gjyshja përpara, Po ban lum po ban fatbardha, Ka ardh çika te daja*. Gjatë perkundjes në djep: *Nina nina nana vet, e kam çit çiken n'djep, Je e mire bukuroshe, Jepja nanes doren nana ta jep mollen*. Në radhën e kujdesit për fëmijët është edhe kujdesi për pastërtinë e tij. Prandaj kjo në këtë të folme nuk mungojnë edhe fjalë dhe shprehje që lidhen me larjen e tyre: *uj te posht çika përpyet; ujt e holl çika e trash; uj te posh djali per pjete; uji i holl djali i t'rash*. Të folmet shqiptare në përgjithësi dëshmojnë një etnografi të të folurit që zhvillohet kundër msyshit, apo me syrin e keq (Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, Morava, Tiranë 2010, f. 53). Në këtë këndvështrim edhe e folmja e kësaj treve ka shprehje që lidhen me këtë dukuri shoqërore: *Sa rrin krypa n'prush, çaç msyshi n'çiken; Sa rrin krypa n'prush, çaç msyshi n'çiken; Sa rrin krypa n'prush, çaç msyshi n'çiken; Sa merr msysh tipia çaç çika*.

3. Fejesa

Akti i parë për nisjen e jetës për trashëgimi bëhet me rastin e fejesës. Në të kaluarën fejesat janë bërë pa e pyetur djalin dhe vajzën. Në Rahovec dhe rrethinë fejesa është realizuar me msit (shkues). Babai i djalit kur ka menduar “të lyp” (të kërkojë) nuse, së pari është interesuar që ta gjejë njeriun e duhur për ta dërguar për msit. Zakonisht msiti i është dhënë duhan me vete si shenjë e përcjelljes së kërkesës për miqësi. Akti i hapjes së bisedës është zhvilluar dikur vonë mbas darke. Bisedës e ka nisur msiti (shkuesi) duke i thënë të zotit të shtëpisë:

- O X (filan), nuk më vete pse kam ardh sonte?
- Nuk â kon zakon me vet mikin pse ki ardh,- ia kthen i zoti shtëpisë.
- Po, po, por un jam me punë sonte.
- Përhajr koft!
- M'ka ba amanetxhi Filani, po ta lyp çikën për djalë.
- Zoti e ñert! Ia kthen i zoti i shtëpisë.

Dhe pasi pret pak, e pyet shkuesin për gjëra që i takojnë të dijë rreth mikut që po ia lyp vajzën. Madje, ka raste që ai është në dijeni dhe nuk e ka ndërmend t'ia japë vajzën, por për ta respektuar msitin e pyet për mikun kërkues se kush është e çfarë gjendje ka dhe i kërkon pak kohë për të menduar, ose edhe ia gjen ndonjë arsytim: *bofsh hajr ti edhe ai, po niher s'e kam nermeñ me dhân kerkuñ*, ose nëse dëshiron që atë natë t'ia këputë për t'i thënë se nuk e pranon miqësinë me të, i drejtohet me fjalët: *Zoti e çoft n'hejr*.

Nëse i mbushet mendja me ia dhënë, d.m.th. ta pranojë miqësinë, i thotë shkuesit: *Flej rahat e shohim nesar, n'koft se ia ka dhân zoti, ja japim edhe na*. Përndryshe i kërkohet kohë për të menduar: *na jep pak kohë t'meñojmë*. Derisa në odën e burrave zhvillohen bisedimet në mesin e grave (grupin shoqëror) bëhet gati *marhâmen* (Marhama është lloj shalli i pambuktë, i punuar në vek, me ngjyrë të bardhë, me gjatësi rreth 1.5 m. E kanë përdorur burrat rreth kapuçit, për ilustrim kujtojeni foton e Idriz Seferit), në ditët tona *peshkirin*.

Me atë rast përgatiten edhe dhurata për dhëndrin dhe njerëzit e familjes së tij. Akti i të bërit përhajr kryhet në mëngjes, sepse në këtë trevë është e njohur shprehja: *më mirë sherri i sabaht se hejri i akshâmit*. Bërjen *përhejr* e kryen më i moshuari i të pranishmëve, nga ana e vajzës. Dikur për ta fejuar vajzën është marrë mendimi edhe i kushërinjve dhe farefisit. Në çastin e të bërit përhajr ngrihen të gjithë në këmbë dhe më i vjetrit ia bën përhajr msitit e më pas edhe të tjerët që janë të pranishëm. Ky rit ekziston edhe sot e kësaj dite, qoftë edhe për të rinj intelektualë, të cilët janë marrë vesh dhe fejesa është punë e kryer, por për hir të zakonit, *me ia lân ñeren familjes* nga djali e vajza respektohet kryerja e fejesës me shkuesi (msitni).

Fejesa përcillet me ceremoni të shkurtër të të bërit *përhajr*: prandaj edhe me këtë rast përdoren fjalë e shprehje që lidhen me të, si: *perhajr ç i e dha (fejove) çiken (vajzën). Çika len n'shpi t'huj, e shkon n'shpi t'vet* etj. Me rastin e fejesës në shtëpinë e djalit ceremonia është më e madhe. Lajmi se erdh *marhâma* është përcjellë me krisma pushkësh. Dhe me rënie të deficit. Me ta dëgjuar lajmin, fqinjët kanë shkuar për perhajr (për urime) dhe janë shprehur: *përhajr ç i zune nuse, e kishe bâ ni mik t'ri? Perhejr!* Në kohë të fundit për *përhajr* (për urime) shkon edhe familja e vajzës dhe me atë rast shtrohet drekë, apo darkë e shoqëruar me muzikë.

4. Dasma

Fshatrat e trevës së Rahovecit martesat i bëjnë ndërmjet shqiptarëve kryesisht në mes fshatrave e më pak me qytetin dhe me zonat tjera. Shumica e martesave kryhen në rrethe të caktuara. Kjo mund të bartë me vete edhe mendimin ose shprehjen: *dhe me dhe, fe me fe*, që do të thotë miku të jetë me doke e zakon të njëjta. Brenda në qytet të Rahovecit, krijimi i miqësive dhe i martesave me fshatra, ka qenë më pak i përhapur. Përqindja e lidhjeve miqësore e hedh poshtë konstatimin e Nushiqit (B. Nushiq, *vep. cit. f. 25*), se gjuhën shqipe në Rahovec e kanë sjellë gratë të ardhura (të martuara) nga fshatrat. Kohët e fundit, si rezultat i emancipimit të femrës, rregulli i martesës vetëm brenda qytetit të Rahovecit ka filluar të mos përfillet.

Tashmë, vajzat rahovecjane, martohen në vende të ndryshme të Kosovës duke marrë me vete elemente gjuhësore të kësaj treve dhe duke u bërë pjesë e një grupi tjetër shoqëror. Martesat ndëretnike, ashtu si në gjithë truallin shqiptar, nuk ekzistojnë. Edhe nëse ndodhin ato mund të jenë ose kanë qenë shumë të rralla dhe janë shumë specifike dhe bëhen pa pëlqimin e familjeve dhe si të tilla nuk përkrahen e miratohen kurrë. Akti që i prin dasmës, pas fejesës, është ndarja e *vades*. Caktimi i kohës për marrjen e nuses i ka paraprirë përgatitjes për dasmë nga ana e atij që merrte nuse dhe kanaxheqit, nga ana e atij që përcillte vajzën (F. Dulaj, *vep. cit. f. 321*).

Si akt ceremonial i paradasmës është edhe *mi çu teshat* (gjithçka që ishte blerë për nusen, nga këpucët te stolitë e arit). Në këtë rast miku shtronte drekë për miqtë. Në përfundim të bukës paguhej “*dashi*”. Pra lireshin para në masën sa mund të blihej një dash, i cili do të therej nga ana e familjes së vajzës për kanaxheq. Kishte raste kur miku detyrohej ta blejë dhe t’ia dërgojë *dashin* mikut. Ndërsa, nëse miku ka qenë i pasur dhe nuk e ka ndjerë të nevojshme nuk ka pranuar që të paguhet *dashi*. Kjo traditë në kohët e fundit nuk praktikohet, por nuk shpëton asnjë rast që të mos përmendet (në formë të mahisë). Krejt çka ka mbetur prej atij zakoni, janë fjalë: *po dashi ku po jet?*

Zakonisht pyet dikush nga fqinjët, apo daja i vajzës. *Aiii po more, s'ka problem, veç kallxo sa duhet*, thotë i zoti i dasmës. *Jo more leje at pu:n, po çfar dashi*, thotë babai i vajzës. *Na do:m mish*, thotë dikush prej fqinjëve. Në ato momente krijohet gjendje dikush pro e dikush kundër dhe bisedën e mbyll ndonjëri prej fqinjëve: *Unë e paguej, un e bie dashin, mos ma nuci mikin* dhe kështu mbyllet biseda. Në fund caktohet koha e ardhjes së krushqve. Në këto raste dëgjohen fjalët: *n'sa ora po na pret o mik?* Ndërsa miku pritës, babai i nuses cakton kohën, ose edhe i jep mundësinë që të zgjedhë miku me fjalë: *n'sa ta don qefi ty, kur t'dush*, por mikut pritës i intereson: *me sa vet vjen?* etj. Miku i përgjigjet me një shifër të përafërt.: *paj valla se di, nja 150 a ma shum*.

Deri para disa vitesh dasmat zgjasnin tri ditë, ndërsa kohët e fundit ato janë reduktuar në dy ditë, apo vetëm në një ditë. Më herët ato janë organizuar në shtëpinë e prindërve të djalit, kurse në kohët e fundit po organizohen në restorane e lokale përkatëse për dasma. Një ditë para se të fillonte dasma mblidheshin *bijat*, (vajzat e martuara, motra, halla e dhëndrit). Ato bëheshin pjesë e punëve përgatitore për dasmë. Rregullonin shtëpinë, dilyn te fqinjët dhe tubonin gjësende që i mungonin shtëpisë që bënte dasmë.

Për të udhëhequr organizimin e gatimeve caktohej *maxhetorja* një grua e fqinjëve, e cila kishte përgjegjësinë e gatimit të bukëve, piteve (byrekëve) dhe gjërave tjera. Ajo ishte përgjegjëse, kurse në ndihmë i vinin edhe gra të tjera. *Akçit*: për përgatitjen e kuzhinës janë marrë mjeshtër që e kanë njohur mirë përgatitjen e gjellëve. Ata janë vendosur në një ambient të veçantë dhe për t'ju ofruar gjërat e nevojshme është caktuar një mashkull nga të afërmit e familjes. Herë pas here ka shkuar edhe i zoti shtëpisë, i cili e pyeste akçinë (gjellëbërësin): *shka i ki punt? A ki boll harxh, mos m'kurse, veç t'bohët mirë. Hiç dert mas ki, krejt i kâm*, ia kthen akçia.

Si në të gjitha trevat e tjera shqiptare edhe në zonën e Rahovecit, në të kaluarën dasma ka pasur karakter më të gjerë sesa kanaxheçi. Edhe gëzimi ka qenë më i madh (Gj. Shkurtaç, *vep. cit.*, f. 60). Të ftuarit kanë qenë të të gjitha lidhjeve me familjen e atij që martonte djalë, apo djem (Gj. Shkurtaç, *vep. cit.*, f. 160). Dasmat dikur organizoheshin në mjedise të ndara, burrat tuboheshin në oda (kulla) dhe gratë në shtëpi. Kjo praktikë ndodh edhe sot e kësaj dite. Por kohëve të fundit shumica e dasmave organizohen në mjedise të përbashkëta, në shtëpi apo restorante të posaçme për dasma. Dasmat i përcjell një program i pasur duke filluar nga ritet e deri tek muzika dhe llojshmëria e këngëve. Më herët edhe muzika ka qenë e ndarë, tjetër për burra, tjetër për gra.

Për burra janë marrë *kâtarë*. Janë kënduar kryesisht këngë me përmbajtje heroike nga e kaluara historike, ku janë përkujtuar trimëri dhe të bëma, por janë kënduar edhe këngë *arshikisht*. Te gratë janë marrë *defatores*, të cilat kanë kënduar me *def*, ndërsa gratë *kan dal me kcy*. Këngët e dasmës te gratë, janë këngë që kryesisht u japin epitete të mira çiftit martesor, djalit dhe vajzë. Në ato raste ngritët lartë kërkesa për jetë të lumtur të të rinjve. Ata konsiderohen si *student* edhe atëherë kur nuk janë të tillë. Më herët janë kënduar këngë që kanë pasur përmbajtje serioze, por edhe gazmore, kurse kohët e fundit ka hyrë (për fat të keq) edhe stili i ashtuquajtur *tallava*, ku përveç ritmit nuk ka asgjë përmbajtjesore.

Fjalët dhe shprehjet në raste martesë janë të ndryshme. Te brezi më i vjetër dëgjohen shprehjet si: Për hajr o X!, “O X a po e marton djalin”(e nëse gjyshi është i pranishëm) O X apo e marton nipin (nëse janë dy nipat)” i zoti i shtëpisë ia kthen: *po, po pe martoj*. I ftuari në dasmë vazhdon *ani përhej e me nafakë*, brezi i ri e thotë: *me fat, e u trashëgofshin, ishalla me këmbë të mbarë* (vjen nusja). Zakonisht në dasma shërbehet në fillim me cigare nga i zoti i shtëpisë. Me këtë rast ai thotë: *merre ni ciqare!* I ardhuri i brezit të vjetër dhe atij të mesëm do ta falënderonte me shprehjen: *t'u rrit nëra!*, ndërsa në rastet e shërbimit me kafe ose me çaj, do të falënderohet i zoti i shtëpisë (pritësi) me shprehjen: *Zoti t'dhasht bereqet, e përhej t'koft!* E çitshi për të mir! Ose dhe *Zoti ta shtoftë bereqetin!* I zoti i shtëpisë (pritësi) do t'u përgjigjej të ftuarve me shprehjet: *ju kthefshim gjithmon n'gzime!*

Kurse brezi i ri uron me një fjalor pothuajse më të unifikuar, ose të standardizuar, ku zotërojnë shprehjet: *u trashëgofshin, jetë të lumtur* etj. Me rastin e shtrimit të darkës i zoti i shtëpisë do të shëtiste në odën e burrave duke iu drejtuar më shprehjen: *A po gjâni nëj kashore?! Ose: A po gjâni naj seň?! (përdorimi i këtyre shprehjeve bëhet për të paraqitur modestinë e mikpritjes), këtë e forcon shprehja: Na boni hallall se keni hjek keq!* Ndërsa përgjigjja e mysafirëve do të ishte: *t'tana të mirat e zotit!* Ashtu si në disa pjesë të Shqipërisë Veriore edhe në fshatrat me rrethinë, nuk ishte zakon që dhëndri të ishte pjesë e dasmorëve (Gj. Shkurtaç, *vep. cit.*, f. 60), që do të shkonin te familja e nuses, por kohët e fundit kjo praktikë ka filluar të ndryshojë, sidomos pas mbarimit të luftës, dhëndri ka filluar të jetë pjesë e dasmorëve.

5. Kulaçi i nuses

Gatimi e *kulaçit* paraqet aktin më interesant që zhvillohet natën e dasmës (të nesërmen merret nusja) në mesin e grave. Në një dhomë tubohen gra dhe vajza, e shtrojnë sofrën në mes të dhomës, merret miell, vezë, qumësht, sheqer dhe yndyrë dhe fillon gatimi. Ndryshe nga tradita në Has, që gatimin e kulaçit e fillon një djalë, në Rahovec me rrethinë, gatimin e kulaçit e fillon një vajzë e re dhe e përfundon një grua e moshuar. Nëse merren dy nuse gatuhen dy kuleçë. Vajza që duhet ta gatuajë kulaçin e vë në gojë një monedhë metalike, të cilën duhet ta mbajë derisa të gatuhet e derisa të piqet kulaçi. Ky akt lidhet me kujdesin që duhet ta ketë vajza, për të mos folur.

Të mosfolurit e vajzës që e gatuan kulaçin lidhet me atë që edhe nusja të jetë e pafjalë, ose siç shprehet populli: *e pagojë*. E gjithë koha e gatimit të kulaçit përshkohet me këngë nga më të ndryshmet, më gazmoret nga të pranishmit: gra dhe vajza. Akti i fillimit të gatimit përshkohet edhe me doza humorit. Vajza që është caktuar ta gatuajë kulaçin ngacmohet me fjalët: *kush e qet kulaçin, e merr burrë kavaçin. Kush e çet kulaçin, të dy duart ju trashin*.

Ndërsa vargjet më të mira shkojnë në llogari të dhëndrit dhe nuses: *Sitet milli n'maxhe t're, pehejr t'koft o bab kjo re. Sitet milli n'maxhe t're, pehejr t'koft oj nân kjo nuse etj*. Për ceremoninë e dasmave mund të vihen në pah edhe përdorimi i veglave muzikore. Ato janë tradicionale: çiftelia, sharkia, tupani, surla, më vonë i është bashkëngjitur edhe violina e defi. Këto vegla janë përdorur te burrat, kurse te gratë janë përdorur kryesisht defat (pra dy defa) gratë apo vajzat që i binin deficit quheshin *defatore*. Kohëve të fundit përdoren instrumente bashkëkohore: dixhej, klarinetë, harmonikë etj.

Këngët që dëgjohen në dasmë nga këngëtarët bashkëkohorë ose nga dixhejtë janë këngë që lidhen me qiftet martesore, por edhe këngë që shprehin aktet patriotike të burrave trima të zonës së Rahovecit: *ku je nise o ilir o vlla, n' Rahovec Teuten me pa: lypa lypa po se gjeta, me bab t'sajna u zateta, ama çiken fort ju luta, ja grabita e s'u tuta*. Me këngën *Mirëmbrema i zoti i shpisë*, e cila ka theks tepër përmbajtjesor e festiv, që kryesisht paraqesin mikpritjen e të zotit të shtëpisë: *Mirmrama, mirmrama i zoti shpis, a ke buk, a ke buk o me na dhâne, sa ka deti, sa ka deti uj e râne*.

Në dasmë i këndohet nuses, të cilën zakonisht e lavdërojnë. Pastaj përshkruhet bukuria fizike: *na ka ardh nusja e bukur mashalla-marshalla, po kcen sikur flutur mashalla- marshalla*, pastaj renditen vargjet ku paraqitet mençuria XX. I këndohet perspektivës që e pret në familjen e re XX etj. Në këtë atmosferë i këndohet edhe familjes së nuses, i lavdërohen prindërit dhe vëllezër e motra. Por ka pasur raste që edhe është sharë e mallkuar familja e nuses. Madje është sharë dhe mallkuar (nemur) aq keq sa që nusja ka shpërthyer në vaj.

Kohëve të fundit, në zonën e Rahovecit, qoftë në qytet apo në fshat, është bërë traditë që mos të mbyllet ceremonia e dasmës pa u kënduar Kënga e “Destan Begit”. Kënga i përket kohës së Perandorisë Osmane. Teksti i kësaj kënge paraqet trimërinë e Destan Begut, i cili i bën thirrje të vëllait që t’ia shalonte (përgatiste) *atin* (kalin), sepse kishte vendosur që të bënte *konakun* në Rahovec, kënga thotë: *Destan Begi kqyr-o sahatin, Ço-u bre Din shiloma atin, Çou bre Din shiloma atin, N'Rahovec e kom konakun, Me pajtue Shallanxhakun...*

6. Zbritja e nuses

Me të arritur në oborrin e dhëndrit rreth kerrit të nuses mblidhen më të afërmit (Kerr i nuses” quhet mjeti me të cilin merret nusja. Disa vite më herët nusja është marrë me qerre). Përgatitet një djalë i moshës 1-2 vjeçare, që njihet si *djali i duvakit*. Ai mbështillet me çarçaf dhe i vihet nuses në prehër. Ideja e këtij veprimi lidhet me dëshirën që nusja të bëjë djem. Nusja i jep një dhuratë djalit të duvakut. Më i moshuari e merr përdore dhe e *zhdryp* nusen nga kerri. Kur ajo zbret në tokë, dhëndëri hedh sheqer nga dritarja. Sipas zakonit shtihet edhe me armë zjarri. Në vazhdim nusja e shoqëruar nga vjehrra dhe kunatat drejtohet nga hyrja.

Ku e pret një enë me sherbet, në të cilën ajo i lyen duart dhe e prek tri herë pragun e shtëpisë. Ideja e këtij veprimi lidhet me atë që nusja ta kalojë një jetë të ëmbël në shtëpinë e re. Fjalët dhe shprehjet që e përcjellin këtë pjesë të ceremonisë së dasmës janë: *Mashalla si bajrak koka! Uuu! si rreze dilli koka! Përhejr/perhajn! Përhajr e me nafa:k!, Ishalla ka ardh me kâm t'mar! Ja pafshi hajrin! Ishalla ta mush shpijen me djem! Ni katun u bâft pi tyne!* etj. Përndryshe kjo pjesë përshkohet edhe me këngë e hedhje vallesh.

7. Hyrja e dhëndrit

Pas kryerjes së të gjitha ceremonive të pritjes vjen momenti i hyrjes së dhëndrit. Në atë ceremoni marrin pjesë familja e ngushtë. Të gjithë bëhen rend për ta përshëndetur dhëndrin, të fundit janë prindërit të cilët ia bëjnë *hallall* të birit mundin nga lindja deri në atë moment. Ata i thonë: *Perhajr e u trashëgofsh, ia pafsh hajrin (hejrin)*. Djali ua kthen: *Faleminderit e ma bâni hallall. Hallall te koft*, i thonë prindërit. Në hyrje të dhomës disa të rinj qëndrojnë të gatshëm për t’ia dhënë ndonjë grusht në shpinë, si shenjë *adeti*. Dhëndri pasi hyn brenda e nxjerr një dhuratë për jashtë duke e hedhur në mesin e turmës. Ai që arrin ta kapë dhuratën quhet me fat. Nëse i bie që ta marrë ndonjë i ri, të pranishmit thërrasin: *Aaaa bravo t’u lshu reñi!*. Më pas, në derë të dhomës së dhëndrit përgjon dikush derisa ai të dëgjohet duke folur me nusen. Më tej nga të pranishmit hidhen valle e këndohen këngë. Derës së dhëndrit i vihet një sofër, e cila simbolizon begatinë.

8. Nxjerrja e dhëndrit

Në mëngjes vjehrra ngrihet herët dhe gatuan *petulla*. Tubohen të afërmit dhe nën tingujve e defit hyjnë në dhomë i gjithë farefisi dhe të afërmit e dhëndrit. Dikur nusja ua ka marrë *doren* të gjithëve që kanë hyrë në dhomë. Kjo dukuri quhet: *me marr do:r*. Ky rit është preferuar nga ana e gjinisë femërore. Vjen momenti i thyerjes së *kulaçit*. Në anën e nuses vihen femrat, kurse në anën e dhëndrit vihen meshkujt. Kapet *kulaçi* nga të dy palët dhe në njëfarë mënyre bëhet garë se kush merr ma shumë, nga *kulaçi*. Shtrohet sofër, apo diçka tjetër dhe hahet nga një copë *kulaç* nga të pranishmit. Akti përmbyllet duke lënë para në sofër, të cilat i takojnë nuses.

9. Kanaxheqi

Me rastin e martesës bëhen ceremoni, po ashtu madhështore, edhe në familjen e vajzës, e njohur si kanaxheqi. Dikur edhe kanaxheqi, ashtu sikur dhe dasma, zgjaste katër ditë. Ditët e kanaxheqit janë ditët e fundit të vajzërisë. Më herët, por ka raste edhe tashti, pasi i kanë *ardh teshat* vajzës nga ana e shtëpisë së dhëndrit, ajo nuk ka dal më përjashta shtëpisë. Ajo iu ka ikur kontakteve me njerëz, e veçanërisht me moshën e rritur e pleq. Kjo ka ndodhur sepse vajzat kanë pasur turp t’u dalin përpara të moshuarve.

Kanaxheqi ka filluar me mbledhjen e bijave dhe ka përfunduar me rastin e nisjes së vajzës për në shtëpinë e burrit. Aktin kulmor të kangjegjit e paraqet momenti i *ngjitjes së kânes*. Ngjitja e *kânes* (ngjyrosjes së flokëve të vajzës) përcillet p.sh. me vargjet: *dil Teute shihe hânen, t'ka ardh koha me ngjit kânen*. Me këtë rast, dikur, ky akt paraqiste momente emocionuese, që përcillej me vaj, jo vetëm të vajzes që bëhej gati për të shkuar nuse, por edhe të gjithë të pranishmeve, sidomos të bashkëmoshatareve.

10. Të marrit ngryk (apo vaj i çikës)

Është përcjellë edhe me derdhje lotësh nga vajza që martohet dhe të gjithë të pranishmit, sidomos bashkëmoshataret, sepse ky moment paraqiste hapin e parë të ndarjes së përvetshme të vajzës nga familja dhe rrethi i gjerë me të cilët ishte rritur. Kur vajza ka filluar t'i mer *ngryk* të pranishmit duke shqiptuar tri herë: *uuujji, uuujji, uuujji*, kori i vajzave dhe grave (kñojseve) duke kënduar vargje prekëse. P.sh: për nënën: *kaj Selvije mos kafsh kurr, qysh pe len nânen për burr*; për vëllain: *baca i madh ka bâ be, tana hijet du mi pre, du mi pre du m'i shkurtu, unë me motren kah kam pushue*.

Vargjet e këngëve të kanaxheqit shkojnë edhe më larg se rrethi i ngushtë familjar, vajzat e këndojnë vajzën edhe për dajat: *kaj Selvije njëju n'ara, kush ju del dajve përpara, une motres ia lash amanet, për m'i prit ma mirë se vet*. Në fund të ceremonisë së marrjes ngryk këndoheshin vargje: *Oj Selvije oj rremi i hânes, amanet shka pi len nânes*; Dhe pasojnë vargjet që vajzat e paragjykojnë si përgjigjeje e vajzës që martohet: *Un ja lâ dhet gishta t'kânes*. Me atë rast i është ofruar *ena me kânë* në të cilën i ka ngjyer dy duart dhe i ka vendos në mur, duke i lënë gjurmët e gishtërinjve, të cilat ka ndodhur që nuk janë fshirë deri sa ka kaluar një vit.

Momentet kulmore prekëse i kanë “zbutur” gratë plaka duke i ngacmuar vajzat tjera (por gjithsesi edhe ato të prekura në shpirt): *shka kini bijo kshtu? Hajt hjat se edhe juve ju vjen reñi! E shihni kur të vjen (vijë) në krye t'javës, do t'vjen me gojën vesh em vesh*. Dhe në këtë moment ndryshon përmbajtja e këngëve. Fillonte sharja edhe për dhëndrin e shtëpinë e tij etj.: *Shka ka pre vjehrrin prâm; ka pre thi me kater kâm; për dhëndrin: ka hyp dhâñrri n'maje t'lisit, pi krun qelet me maje t'briskit; ose: O Hajdar o shkollavan, lapcin n'tok e libret n'tavan*.

Pas kalimit të fazës së *vajt të çikes* situata merr karakter gëzimi, që përshkohet me biseda dhe me evokime e parashikime për jetën. Fillon të përgatitet vajza për nuse. Ajo vesh teshat e nusërisë. Me përgatitjen e saj merret *telexhisja* (Has: *telatorja*), e cila e *bân gati* për të shkuar te burri. Kur merrej nusja miku ka lënë para për *telegjisjen* si shpërblim për punën që e ka kryer. *Telexhise* është caktuar dikush nga familja, motrat, kunatat, apo tezet. Ajo nuk është dashur të jetë me çdo kusht njohëse e mirë për këtë punë, sepse në ndihmë të saj kanë shkuar ato gra dhe vajza që e kanë njohur mirë zanatin.

Kur nusja ka shkuar te burri, për mënyrën e përgatitjes janë bërë komente: *o sa mirë e kishin bâ gati bre, ju lumshin durt, por edhe iu thafshin durt se për çyçe n'rrem e kishin bae*”. Tashti asnjë nuse nuk përgatitet në shtëpi, të gjitha shkojnë në sallone bukurie dhe përgatiten në mënyrë profesionale, nga siç i quajnë: *frizerkat*. Por çmimi i bërjes gati paguhet nga ana e mikut (familja e dhëndrit). Një moment tejet prekës, ka qenë momenti i nisjes së nuses. Ka pasur raste kur nga gratë dhe vajzat e palës së vajzës janë kënduar edhe këngë me përmbajtje fyese për *krushkat* (gratë e kerrit): *koki t'mdhaja, koki t'mira, i paski dhâmt, me nxerr kumpira, ose: ka vesh vjehrra patika t'bardha, n'fuboll ka dal e para, ose: kur t'thot vjehrra bani punt', merre shkâmin theja huñt', apo për vjehrrin: po thot Xhela jam zingjin, i lidh apângat me sixhim*.

Edhe krushkat nuk heshtin, por edhe ato ua kthejnë fyerjet, mirëpo jo në të njëjtën masë dhe me të njëjtën gjuhë. Vargjet më të shpeshta kanë qenë: *Morem lulen kulumrijes, ja lam therrën t'zotit shpijes*. Nëse vajza nuk ka qenë e sjellshme, ndonjë plakë, flet me kujdes, që mos të dëgjohej nga familjaret e afërt: *Hajt hajt se valla lul e therr i murt me veti!* Duke jetuar në rrethana të ndryshme shoqërore edhe urimet ndryshojnë sipas brezave, ndryshe urojnë plakat e ndryshe të rejat.: *Përhajr ju koft kjo vade! (kjo ceromoni). Ishalla bahet rahat/raha::t (Krushe), ishalla i pelqen shñeta, ishalla s'ja ki gajlen*. Kurse të rejat përdorin togfjalësja bashkëkohore, si: *u trashëgofshin, jetë të lumtur, paçin jet t'lumtur*, etj.

Tradita e vjetër e kanaxheqit ka filluar të humbasë në kohën tonë. Ceremonitë e kanaxheqit kanë filluar të reduktohen. Kanaxheqet sot më shumë u ngjajnë dasmave. Shumica organizohen në lokale e restaurante, kështu që atyre u mungojnë shumë elemente nga e kaluara. Kanaxheqi sot nuk ofron as për së afërmi madhështinë që kishte dikur. Atij i mungojnë sidomos aktet emocionuese të cilat i kishte kanaxheqi dikur. Si shprehje që e shoqëron ceremoninë martesore të vajzës, që dallon edhe fjalori në krahasim me dasmën është i ndryshëm. Thirrja për *përcjellje*, siç quhet me rastin e ftesës për kanaxheq: *filani ka perciellje, t'ka thirr mi dal n'zjem*. *Zjem* është quajtur, sepse aty ku është bërë pritje e krushqve, zakonisht në ambiente të hapura, është ndezur zjarr.

11. Përfundimi

Në këtë punim jemi përpjekur të përshkruajmë ligjërimin popullor shqiptar sipas grupeve shoqërore dhe rrethanave, duke e parë atë sipas parimeve sociolinguistike të ngritura fillimisht në Amerikë e pastaj edhe në Evropë dhe në vendin tonë. Pra, për realizimin e këtij punimi jemi mbështetur në teoritë sociolinguistike të ngritura nga J. Fishman, Lawrov, R. Hudson, E. Çabej, Q. Haxhihasani, Gj. Shkurtaç etj. Rezultatet e këtij hulumtimi vënë në dukje se gjuha ka evoluar në rrjedhë të kohës. Ajo ka ndryshuar si në aspektin diakronik edhe në aspektin sinkronik. Normim i shqipes ka bërë që shumë dukuri të kalojnë kufijtë e të folmeve, nëndialekteve dhe dialekteve drejt trajtave dhe formave të përbashkëta gjuhësore. Ajo që mbetet ende e paprekur, në kuptimin e ndarjes së shoqërisë, është ndarja apo dallimet në mes të gjinisë. Siç duket nga hulumtimet e bëra në terren edhe për një kohë do të vijojë organizimi i ndarë i ceremonive familjare dhe si rrjedhojë do të përballemi edhe me ndarje gjuhësore në mes të gjinive.

Referencat

- [1]. Richard A Hudson, *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë 2002
- [2]. Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, Morava, Tiranë 2009
- [3]. Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, Morava, Tiranë 2010
- [4]. Fridrik Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP, Prishtinë 2016